



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



05/ 4948 /2021

08.06.2021

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 neni 35, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë:

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:

- Një (1) mësimdhënës/e e Arsimit Fillor në SHFMU “Ilaz Thaçi”-paralelja Krivenik, vend i lirë.
- Një (1) mësimdhënës/e e Arsimit Fillor në SHFMU “Ilaz Thaçi”-pushim i lehonisë nga muaji shtatorë 2021.
- Një (1) mësimdhënës/e e lëndës së Historisë në SHFMU “Ilaz Thaçi”-pushim i lehonisë nga muaji shtator 2021.
- Një (1) mësimdhënës/e e lëndës TIK-ut në SHFMU “Ilaz Thaçi”-pushim i lehonisë nga muaji tetorë 2021.

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Lloji i pozitës: nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: katër (4)

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Shkollës

Grada/Koeficienti: Koeficienti A-421/1

Orët e punës: 40

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mesimdhënies;
- Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mesimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
- Të marrë pjese aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit, të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/a jo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

1. Arsimi Fillor :

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor;
- Fakulteti i Mësuesisë;

2. Histori :

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);

3. TIK: Programi/Dega teknologji-informatikë;

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit(300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i, tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 08.07.2021 deri 22.07.2021

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe në për kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në tabelën e shpalljes.

Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Menduh Vlasi

